
REGULLORE KOMBETARE SPORTIVE

FEDERATA SHQIPTARE E
SPORTEVE TE
AUTOMOBILIZMIT

TIRANE 2008

Rregullore Kombetare Sportive

Kapitulli 1

Principe te përgjithshme

Neni 1 – Rregullorja Nderkombetare e Sportit

Federata Nderkombetare e Automobilizmit (FIA) eshte e vetmja fuqi sportive qe mund te percaktoje dhe mund te detyroje te aplikohen rregullore qe synojne favorizimin dhe rregullimin e aktiviteteve sportive dhe rekordeve automobilistike, si dhe organizimin e Kampionateve Nderkombetare automobilistike; ajo ka te drejte te krijojë Gjykatën Nderkombetare qe ngarohet te gjykoje cdo mosmarrëveshje qe mund te lindi ne fushen e Sportit Automobilistik Nderkombetar.

FIA, ne kategorine Karting mund te delegoje nga viti ne vit fuqine e saj sportive nderkombetare kujtdo organizmi te njohur prej saj, qe do te kete detyren e drejtimit te aktivitetit sportiv nderkombetar te kategorise Karting duke respektuar rigorozisht Ligjin Nderkombetar mbi Sportin dhe rregulloret e tjera te FIA.

Neni 2 – Ligji Nderkombetar mbi Sportin

Per te bere te mundur ushtrimin e fuqive te saj ne menyre korrekte dhe te barabarte per te gjithë, FIA ka krijuar dhe shpallur Ligjin Nderkombetar mbi Sportin. Qellimi i këtij Ligji eshte nxitja dhe lehtësimi i zhvillimit te sportit automobilistik ne shkalle nderkombetare. Ky Ligj nuk do te aplikohet kurre per te penguar pjesëmarrjen e nje sportisti, me përjashtim te rasteve kur FIA gjykon se pjesëmarrja e këtij sportisti cenon kushtet e sigurise, drejtesise dhe rregullsise te vete gares.

Neni 3 – Rregullore Kombetare e Sportit te Automobilizmit

Çdo Automobile Club apo Federate Kombetare qe ben pjese ne FIA eshte e detyruar te pranoje Ligjin Nderkombetar mbi Sportin dhe ta respektojë ate. Duke marre parasysh kete detyrim, FIA njeh vetem nje Automobile Club ose vetem nje Federate per cdo shtet (ASN) si fuqi te vetme sportive te kualifikuar per te aplikuar Ligjin Nderkombetar mbi Sportin dhe per te përcaktuar rregullat e sportit automobilistik ne te gjithë territorin e atij shteti.

Neni 3/2 – Sporti i Automobilizmit ne Shqiperi

Automobile Club Albania (ACA) është enti i njohur nga FIA si përfaqësues i vetëm i fuqisë sportive (ASN) në territorin e Shqipërisë. Gjate disiplinimit të Sportit Automobilistik Kombëtar, ACA është e detyruar të përmbahet Ligjit Nderkombëtar mbi Sportin dhe kësaj Rregulloreje Kombëtare Sportive (RKS), si dhe të respektojë autoritetin e FIA dhe të Gjykatës Nderkombëtare të Apelit. Çdo Automobile Club rajonal (AC), gjate zhvillimit të detyrave të tyre në sektorin e aktiviteteve sportive, duhet të nënshtrohen autoritetit të organeve të krijuara nga ACA për respektimin e fuqisë sportive dhe autoritetit të organeve nderkombëtare të lartpërmendura.

Neni 4 – Ushtrimi i fuqisë sportive në territorin e mbuluar nga një ASN

Njesite territoriale autonome të një Shteti i nënshtrohen fuqisë sportive të ushtruar nga ASN që përfaqëson Shtetin në FIA.

Neni 5 – Delegimi i fuqisë sportive

Çdo ASN ka të drejtë të delegojë një ose më shumë AC rajonal, pjesërisht apo tërësisht, fuqite sportive që i njihen nga Ligji Nderkombëtar mbi Sportin, por vetëm me aprovim të FIA.

Neni 6 – Anullimi i delegimit të fuqisë sportive

Një ASN mund ta anulojë të drejtën e përfaqësimit të saj nga një AC duke lajmëruar në FIA.

Neni 7 – Rregullorja Kombëtare Sportive

FASA ka përpunuar dhe shpallur këto Rregullore Kombëtare Sportive se ciles duhet të nënshtrohet detyrimisht kushdo që zhvillon aktivitet sportiv në fushën e automobilizmit në Shqipëri. Për çdo çështje që nuk citohet shprehimisht në këto Rregullore, duhet të konsultohet Ligji Nderkombëtar mbi Sportin si dhe Rregulloret e Vecanta të Gares (RVG). Qëllimi i RKS është nxitja dhe lehtësimi i zhvillimit të sportit të automobilizmit në shkallë kombëtare. RKS nuk do të aplikohet kurrë për të penguar pjesëmarrjen e një sportisti, me përjashtim të rasteve kur FASA gjykon se vendime të tilla janë të nevojshme që sporti i automobilizmit në Shqipëri të zhvillohet në kushtet e sigurisë, drejtësisë dhe rregullsisë maksimale.

Neni 7/2 – Ushtrimi i fuqisë sportive

Ushtrimi i fuqisë sportive të ACA realizohet nepermjet FASA, e cila për pasoje përfaqëson Autoritetin Sportiv Kombëtar (ASN). FASA ka të drejtë të përfaqësojë sportin e automobilizmit në FIA dhe në organizmat e tjere sportive nderkombëtare të automobilizmit.

Neni 7/3 – Publikime zyrtare të FASA

FASA ve në dijeni gjithë të interesuarit mbi modifikimet dhe azhurnimet e aplikuara mbi RKS nepermjet publikimeve zyrtare (Vjetori i FASA, faqja zyrtare e internetit, revistat e specializuara, etj.) dhe/ose nepermjet mjeteve të tjera të përshtatshme informuese.

Neni 7/4 – Zbatimimi i rregullores

Kushdo qe merr pjese ne aktivite sportive ne fushen e automobilizmit eshte i detyruar te pajiset me licence te leshuar nga FASA dhe te njohe e te zbatoje Ligjin Nderkombetar mbi Sportin, RKS dhe Rregulloret e Veçanta te garave (RVG). Çdo sportist duhet gjithashtu:

1. Te vezhgoje dispozitat e shpallura nga FASA dhe nga personat perberes te këtij organizmi te caktuar ne funksione zyrtare.
2. Te pranoje pa kushte pasojat qe mund ti vijne nga pjesëmarrja ne aktivite sportive ne fushen e automobilizmit dhe nga rregullorja qe drejton keto aktivite.
3. Te mos leshoje deklarata publike qe mund te cenojne interesat e këtij sporti apo te demtojne mbarëvajtjen normale te aktiviteve sportive.
4. Ti përmbahet ne cdo rrethane principit te ndershmerise dhe dinjitetit sportiv.

Te gjithë sportistet e licencuar, ne baze te nënshkrimit te kerkeses se pajisjes me licence sportive nga FASA, zotohen te pranojne dhe respektojne teresisht rregullat qe percaktojne mbarëvajtjen e sportit te automobilizmit dhe te gjithë vendimet e dispozitat e organeve kompetente. Te dhenat personale qe gjenden ne kerkesen per licence do te regjistrohen ne nje Database te krijuar dhe administruar nga FASA. Keto te dhena do te perdoren per te arritur qëllimet e përcaktuara ne rregulloret e FASA. Per keto qellime, informacione te veçanta qe kane te bejne me vlefshmerine e licencave dhe ushtrimin e aktiviteve sportive automobilistike mund ti komunikohen enteve publike dhe subjekteve private te interesuara. Lista e mbajtësve te licences sportive mund te publikohet nga FASA nepermjet cdo mjete komunikimi.

A) Klauzolë kompromisi

Te gjitha mosmarrëveshjet e lindura ndermjet sportisteve te licensuar apo ndermjet sportisteve te licensuar dhe FASA ne lidhje me te drejttat ne aktivite sportive automobilistike do te zgjidhen duke ndjekur Proceduren e Pajtimit dhe Proceduren e Gjykimit te parashikuara ne kete nen. Te gjitha vendimet mbi keto ceshtje i marrin organet e drejtesise sportive. Organi i FASA qe shqyrton dhe gjykon keto ceshtje nuk eshte i perhershem dhe funksionon ne baze te rregullave te paravendosura nga FASA. Sportistet e licensuar nga FASA heqin dore nga përfshirja e Autoriteve te tjera te ndryshme nga ato sportive, per te mbrojtur interesat apo te drejttat qe kane te bejne me sportin. Komiteti Ekzekutiv mund te beje përjashtim per kete rregull per arsye te veçanta dhe te justifikuara, por vetem pasi te jete tentuar zgjidhja e mosmarrëveshjes nepermjet Procedures se Pajtimit te parashikuara ne kete nen. Mos respektimi i kësaj klauzole dhe procedurave te parashikuara ne kete nen, do te sanksionohet sipas rregullave te përcaktuara nga FASA.

B) Procedura e Pajtimit

Kerkesa per fillimin e Procedures se Pajtimit, e pajisur me dokumentacionin dhe provat perkatese, i drejtohet Sekretarise se FASA nga pala kërkuese. Kerkesa e lejes per t'iu drejtuar

organeve gjyqesore pa qene konsumuar me pare Procedura e Pajtimet, konsiderohet automatikisht si kerkese per fillimin e Procedures se Pajtimet. Pas marrjes se kerkeses per fillimin e procedurave, Sekretaria e FASA duhet ti dergoje nje kopje pales/ve te përfshire/a duke caktuar nje afat maksimal prej 30 ditesh per dergimin e nje letre sqaruese te pajisur me cdo dokument te mundshem qe ka te beje me ceshtjen ne fjale. Per cdo mosmarrëveshje gjykatësi perzgjidhet nga Presidenti i Komisionit Juridik nga nje liste e paracaktuar dhe e azhornuar periodikisht. Gjykatësi shqyrton shkresat dhe dokumentacionin perkates dhe therret palet per te degjuar pretendimet, se bashku apo veçmas. Audicioni duhet te caktuar me nje afat maksimal prej 30 ditesh nga zgjedhja e gjykatësit. Palet e thirrura duhet te jene prezent dhe mund te shoqerohen nga nje mbrojtës apo këshillues. Pasi te shqyrtohet ceshtja dhe te jene degjuar palet e përfshira, gjykatësi propozon nje formule pajtimi. Nese te gjitha palet bien dakord me formulën e pajtimet te propozuar, gjykatësi përgatit dhe nënshkruan nje raport qe permban kete formule dhe qe duhet nënshkruar nga palet per te verifikuar pranimin. Nese propozimi i pajtimet nuk aprovohet nga te gjitha palet, brenda 30 diteve gjykatësi duhet te pergatise nje raport mbi tentativen e pajtimet, duke sqaruar ne detaje pozicionet e paleve.

C) Procedura e Gjykimit

Ne rast se tentativa e pajtimet permyllet negativisht, zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndermjet sportistëve te licensuar apo sportistëve te licensuar dhe vete FASA do ti besohet nje Keshilli Gjykatesish. Mund ti nënshtrohen gjykimit te nje Këshilli Gjykatesish edhe mosmarrëveshje qe lindin ndermjet FASA dhe te tretëve per ceshtje qe kane te bejne me te drejta apo aktivitete te lidhura me sportin e automobilizmit, nese te tretet pranojne shprehimisht Klauzolen e Kompromisit te përfshire ne kete nen dhe procedurat e FASA. Procedura e Gjykimit zhvillohet sipas rregullave te përcaktuara paraprakisht nga FASA.

Kapitulli 2

Nomenklatura dhe përkufizime

Neni 8 – Nomenklatura, përkufizime dhe shkurtime

Nomenklatura, përkufizimet dhe shkurtime e paraqitura ne artikujt vijues jane përdorur ne kete RKS dhe ne te gjithe rregulloret e veçanta.

Neni 9 – FIA

Federata Nderkombetare e Automobilizmit (*Fédération Internationale de l'Automobile*)

Neni 10 – ASN

Automobile Club apo Federate kombetare e njohur nga FIA si mbajtes i vetem i fuqise sportive te nje Shteti.

Neni 11 – CS

Komisioni Sportiv i nje ASN.

Neni 12 – Shkurtime te tjera

Ligji – Ligji Nderkombetar mbi Sportin

AC – Automobile Club rajonal

ACA – Automobile Club Albania

FASA – Federata Shqiptare e Sporteve te Automobilizmit

RKS – Rregullore Kombetare Sportive

GNA – Gjykata Nderkombetare e Apelit

GKA – Gjykata Kombetare e Apelit

Neni 13 – Mjete tokesore

Me mjet tokesor nenkuptohet cdo mjet motorik qe zhvendoset duke pasur kontakt konstant me terrenin ne menyre te drejtperdrejte nepermjet mbeshtetjes mekanike apo ne menyre jo te drejteperdrejte per shkak te terrenit, levizja dhe trajektorja e te cilit kontrollohet teresisht dhe ne menyre konstante nga nje pilot ne kabine. Ne mjetet tokesore perfshihen:

a) Automobilat

Nje automobil eshte nje mjet tokesor me te pakten kater rrota qe jane gjithnje ne kontakt me terrenin, nga te cilat te pakten dy sigurojne zhvendosjen dhe te pakten dy mundesojne drejtimin.

b) Mjetet speciale

Mjet special eshte nje mjet me te pakten kater rrota, zhvendosja e te cilit nuk sigurohet nga rrotat.

c) Mjet me efekt ndaj terrenit

Mjet me efekt ndaj terrenit eshte nje mjet qe zhvendoset duke u mbeshtetur mbi terren nepermjet nje jasteku me ajer te komprimuar.

d) Autoveture

Me autoveture (apo veture ne perdorimin e zakonshem) nenkuptohet nje automobil qe perdoret vetem per transport personash, ne numer jo me te madh se nente. Veturat qe marrin pjese ne cfaredo aktiviteti sportiv, kombetar apo nderkombetar, duhet te respektojne rregulloren teknike te FIA dhe rregulloren e publikuar nga FASA. Karakteristikat e tyre teknike duhet te shfaqen ne pasaporten teknike te seciles autoveture.

Neni 13/2 – Konstruktore

Me emertimin Konstruktore nenkuptohet ai qe ka ndertuar makinen ne cdo pjese te saj, si dhe ai qe ka realizuar modifikimet dhe karakteristikat specifike duke perdorur pjese nga furnitore te ndryshem dhe ka per qellim ta regjistroje dhe te kerkoje certifikaten e origjines. Kombesia e nje autoveture eshte e njejte me kombesine e Konstruktore te njohur nga ASN e Shtetit te tij.

Neni 14 – Cilindrata

Cilindrata eshte vellimi i formuar ne motor si rezultat i levizjes drejtvizore i/te cilindrit/ave ne motoret alternativ ose nga zhvendosjet kendore te rotorit ne motoret rotativ. Ky vellim eshte i shprehur ne centimetra kub dhe per gjithë perlllogaritjet mbi cilindraten e motorit, numri Pi grek konsiderohet ne menyre konvencionale i barabarte me 3,1416.

Neni 15 – Klasa

Ndarje e mjeteve sipas cilindrates-motorit apo sipas kritereve te tjera dalluese

Neni 16– Aktivitete sportive

A) AKTIVITETET SPORTIVE DHE KLASIFIKIMI I TYRE

Nje aktivitet sportiv eshte nje ngjarje ne te cilen marrin pjese vetura qe synojne konkurimin. Cdo aktivitet sportiv mund te perfshije nje apo me shume gara individuale ose kolektive, me karakteristika dhe klasifikime te vecanta. Sipas kombesise se piloteve dhe konkurrenteve pjesemarres, gara mund te jete “Kombetare” apo “Nderkombetare”. Gjithashtu garat mund te jene “Te Rezervuara” apo “Te Mbyllura”. Sipas karakteristikave, qellimit dhe nivelit te veshtiresise fizike, aktivitetet sportive klasifikohen ne:

- Profesionale (niveli i 2-te)
- Semi-Profesionale (niveli i 1-re)
- Diletante

Aktivitetet automobilistike jane te nivelit te pare dhe te dyte kur pilotet pjesemarres kane si qellim pozicionimin e tyre ne nje vend sa me te larte ne klasifikimin perfundimtar qe perpilohet duke u bazuar ne kritere si: koha e nevojshme per te pershkuar nje distance te caktuar; respektimi i koheve per te pershkuar pikekalimet e rruges se paracaktuar; aftesia e drejtuesit te mjetit;

besueshmeria dhe cilesia e autoveturave, etj., dhe mund te perpilohet edhe nga kombinimi i nje apo disa prej kushteve e mesiperme.

Aktivitetet sportive quhen Diletante kur zhvillohen vetem me qellim argetimi dhe klasifikimi perfundimtar (nese perpilohet nje i tille) bazohet ne zhvillimin e disa lojrave dhe quiz-eve apo kushteve te tjera (si p.sh. konsumi) dhe koha perjashtohet si kusht.

A1) Aktivitete Profesionale

Bejne pjese ne kete perkufizim aktivitetet e sektoreve te meposhtem, mbarevajtja e te cileve percaktohet ne rregullore te posacme:

- shpejtesi ne cirkuit
- shpejtesi ne ngjitje
- rrallyes
- rrallyes tout-terrain
- shpejtesi ne toke (autocross)
- shpejtesi ne akull
- formula challenge
- rallycross
- slalom
- shpejtesi jashte-rruge
- vetura epokale (shpejtesi ne cirkuit, shpejtesi ne ngjitje, rrallyes)
- persheptim
- gara te perziera shpejtesie dhe rregullsie
- karting (shpejtesi)
- tentative rekordi
- gara per mjete me energji alternative.

A2) Aktivitete Semi-Profesionale

Perfshihen ne kete perkufizim aktivitetet e sektoreve te meposhtem, mbarevajtja e te cileve percaktohet ne rregullore te posacme:

- gara rregullsie (te gjithe sektoret, vetura moderne dhe vetura epokale)
- jashte-rruge Trial
- gymkane
- aktivitete eksperimentale dhe aktivitete semi-profesionale karting.

A3) Aktivitete Diletante

Perfshihen ne kete perkufizim aktivitetet e sektoreve te meposhtem, mbarevajtja e te cileve percaktohet ne rregullore te posacme:

- mbledhje dhe organizime turistike (te gjithe sektoret, vetura moderne dhe epokale)

- gjetje thesari
- prova konsumi
- aktivitete sporadike promociionale.

B) GARA (ose Konkurime)

Perkufizohet si e tille nje gare (apo nje konkurim) e vetme qe shpall rezultatet e saj. Nje gare mund te perfshije prova te lira, prova kualifikimi, manche, finale apo seri, por duhet te zhvillohet ne nje aktivitet te vetem. Nje gare fillon me verifikimet administrative dhe teknike dhe perfundon me permbylljen e nje prej ketyre ngjarjeve, kushdo verifikohet e fundit:

- perfundimi i reklamimeve apo ankesave, ose mbyllja e mbledhjes se Kolegjit te Komisareve Sportive
- perfundimi i verifikimeve post-gare, qe zhvillohen konform rregullave te percaktuara ne kete RKS
- dhenia e cmimeve.

Garat qe bejne pjese ne Kampionate, Kupa, Trofe, Challenge dhe Seri nderkombetare te pamiratuara nga FIA nuk mund te rregjistrohen ne Kalendarin Sportiv Nderkombetar.

B1) Gara ne cirkuit (perfshi dhe garat per makina epokale)

Keto jane gara qe zhvillohen ne nje cirkuit te mbyllur, ndermjet dy ose me shume veturave qe konkurojne njekohesisht. Faktori determinant per percaktimin e klasifikimit perbehet nga shpejtesia apo nga distanca e pershkuar ne kohen e paracaktuar.

Garat e meposhtme permbliiden ne garat ne circuit: shpejtesi ne toke (autocross), shpejtesi ne akull, rallycross, formula challenge, gara ne mini impiante dhe karting.

B2) Gara ne ngjitje (perfshi dhe garat per makina epokale)

Keto jane gara ne te cilat veturat nisen individualisht per te pershkuar nje rruge te perbashket per te gjitha veturat deri ne vijen e finishit e cila dodhet ne nje lartesi me te madhe se vija e fillimit. Faktori determinant per percaktimin e klasifikimit eshte koha e nevojshme per pershkimin e kesaj distance.

B3) Slalom

Jane gara aftesie drejtimi qe zhvillohen ne rruge speciale te perbera nga shume kthesa qe detyrojne pilotin te beje nderrime te shpeshta trajektoreje. Klasifikimi percaktohet nga shuma e pikeve te fituara ne baze te kohes me penalizimet e mundshme.

B4) Shpejtesi jashte-rruge dhe Jashte-rruge trial

Garat e shpejtesise jashte-rruge jane gara per mjete 4x4 ne te cilat tejklimi i pengesave natyrore te pranishme ne terren te papershtatshem per vetura te zakonshme ne kohën me te ulet te mundshme perben faktorin determinant per percaktimin e klasifikimit.

Garat jashte-rruge trial jane gara per mjete 4x4 ne te cilat vetem aftesia per te tejkaluar pengesat perben faktorin determinant per percaktimin e klasifikimit.

B5) Gara pershpejtimi

Keto jane gara pershpejtimi ndermjet dy veturave qe nisen njekohesisht nga pozicioni i ndaluar, per te pershkuar nje trajektore te drejte te matur me saktësi. Klasifikimi percaktohet nga respektimi i koheve te paracaktuara te pershkimit.

B6) Gara per mjete me energji alternative

Jane gara per mjete qe perdorin energjine elektrike ose motor termik te ushqyer me karburante qe respektojne ambientin. Klasifikimi mund te percaktohet, ne varesi te karakteristikave te gares, nga koha e nevojshme per te perfunduar garen, nga respektimi i koheve te paracaktuara per te pershkuar pikekalimet e vendosura gjate rruges apo nga shuma e pikeve qe i perkasin kohes me penalitetet.

B7) Gara rregullsie

Jane gara ne te cilat respektimi i kohes se paracaktuar per te pershkuar disatancat ndermjet pikekalimeve ne rruge eshte faktor determinant qe vendos klasifikimin. Ne garat e rregullsise nuk parashikohen prova speciale (si p.sh. Rallyes). Kur keto gara zhvillohen ne rruge interurbane, shpejtesia mesatare nuk duhet te tejkaloje shpejtesine maksimale te paracaktuar nga Kodi Rrugor.

B8) Gymkane

Keto lloj garash parashikojne kalimin ndermjet birilave te vendosur ne distance te vogel ndermjet njeri-tjetrit dhe te dallueshem lehtesisht me sy, ku klasifikimi percaktohet duke mbledhur ne menyre algjebrike piket e fituara ne baze te kohes se perfundimit te gares me penalizimet (ose cmimet) e marra gjate zhvillimit te manovrave akrobatike (te pakten dy per gare) qe duhet te kryhen ne menyre te tille qe vetura te jete e detyruar te ndaloje per te perfunduar manovren.

B9) Gjetje thesari dhe Prova konsumi

Gjetjet e thesarit jane aktivitete qe kane per qellim mbledhjen e pjesemarresve ne nje pike-takimi te caktuar. Per te arritur ne kete pike-takimi pjesemarresit duhet te zgjidhin gjate rruges disa quiz-e dhe te perfundojne disa detyra qe i komunikohen nepermjet radios. Klasifikimi percaktohet vetem nga penalizimet e marra gjate zgjidhjes se quiz-eve dhe perfundimit te detyrave te dhena.

Garat e konsumit jane aktivitete ne te cilat klasifikimi percaktohet vetem nag konsumi I karburantit.

B10) Gara te tjera te nivelit te pare dhe Diletant

Jane gara dhe aktivitete qe nuk bejne pjese ne skemat e lartpermendura dhe qe kane karakteristika qe aprovohen sipas rastit.

Neni 17 – Gara Nderkombetare

Gare e hapur per te gjithë pjesemarresit qe jane te pajisur me nje liçence te nje ASN te huaj. Ne baze te Ligjit Nderkombetar mbi Sportin dhe kesaj RKS, kombesia e nje konkurruesi apo piloti eshte ajo e ASN qe I ka leshuar liçencen sportive. Asnje gare nuk mund te zhvillohet nese nuk eshte regjistruar me pare ne Kalendarin Sportiv Nderkombetar, edhe nese perfshihet ne Nenin 19. Regjistrimi ne Kalendarin Sportiv Nderkombetar eshte kompetence e FIA dhe duhet te behet nepermjet FASA. FIA mund te refuzoje regjistrimin duke motivuar vendimin e saj. Garat qe nuk jane regjistruar ne kete kalendar jane te ndaluara per sportistet me licence te huaj, pervec rasteve te cituara ne Nenin18.

Neni 18 – Gara Kombetare

Nje gare eshte kombetare kur eshte e hapur vetem per pjesemarres me licence sportive te leshuar nga FASA dhe eshte e regjistruar ne Kalendarin Sportiv Kombetar te FASA. Per garat qe zhvillohen ne BE (ose ne Shtetet e asimiluara dhe te percaktuara sit e tilla nga FIA), nje gare kombetare mund te pranoje konkurente me licence te leshuar ne nje nga vendet e BE apo te Shteteve te asimiluuar, nese vete gara eshte regjistruar ne kalendarin e FIA si gare kombetare me pjesemarrje te huajsh.

Neni 19 – Gare e Rezervuar

Nje gare kombetare apo nderkombetare konsiderohet e rezervuar kur, per te marre pjese konkurentet duhet te plotesojne disa kushte specifikë te percaktuara ne Regulloret e vecanta te garave. Keto kushte mund te perfshijne cilesi apo kerkesa ne lidhje me sportistet te ndryshme nga ato te percaktuara ne Nenet 17 dhe 18, ose karakteristika te vecanta te veturave qe nuk perfshihen ne regulloret teknike kombetare dhe nderkombetare. Te rezervuara jane edhe garat me ftese, me kusht qe kriteret e fteses te jene te percaktuara. Ne situata te jashtezakonshme FIA mund te autorizojë nje ASN qe te regjistrojë ne Kalendarin Sportiv Nderkombetar nje gare nderkombetare te rezervuar e cila, ne cdo rast duhet ti permbahet dhe te respektojë Ligjin Nderkombetar mbi Sportin.

Neni 20 – Gara e mbyllur

Nje gare eshte e mbyllur kur ne te mund te marrin pjese vetem anetaret e nje AC te cilet jane gjithashtu te pajisur me licence sportive nga FASA. Per tu organizuar, nje gare e mbyllur duhet te autorizohet me pare nga FASA.

Neni 21 – Rallyes dhe Rallyes Tout Terrain

A) RALLYE I KATEGORISE SE PARE

Nje Rallye eshte nje gare rregullsie qe zhvillohet pergjate nje rruge te ndare ne sektore (sektor - pjese rruge ndermjet dy pike-kalimeve) ne te cilet zakonisht perfshihen pjese rruge urbane ose interurbane ku eshte i detyrueshem respektimi i Kodit Rrugor, si dhe pjese per shpejtesi te larte ne rruge te vecanta ku nuk ka qarkullim rrugor (Prova Speciale). Pjesa e rruges ku nuk perfshihet prova speciale quhet “rruga e transferimit”.

Garat Rallyes te kategorise se pare qe duhet te regjistrohen ne Kalendarin Sportiv Nderkombetar mund te pranojne pilote te klasifikuar “Cmimi i Madh” nga FIA. Gjithsesi nese nje Rallye perfshin prova speciale ne cirkuite te perhershme apo gjysem te perhershme per me shume se 10% te kilometrazhit total te gares, pjesemarrja e piloteve te klasifikuar “Cmimi i Madh” eshte e kushtezuar nga regjistrimi i gares ne kalendarin e garave te shpejtesise si “Gare Nderkombetare e Lire”. Nese organizatoret deshirojne, mund te ruhet regjistrimi i njekohesishem edhe ne kalendarin rallye.

Garat rallye qe perdorin pjeserisht rruge qe perdoren edhe per qarkullimin e zakonshem te automjeteve, por qe perfshijne prova speciale ne cirkuite te perhershme apo gjysem te perhershme per me shume se 20% te kilometrazhit total te gares, nuk mund te regjistrohen ne Kalendarin rallye pasi konsiderohen si gara shpejtesie.

Fuqia e veturave te pranuar ne rallye nderkombetar te kategorise se pare eshte limituar ne 300 kf. FIA mund te nderhyje ne cdo moment dhe ne cdo suate qe limiti i fuqise te respektohet.

Ne garat rallye nderkombetare mund te marrin pjese vetem:

- Vetura turizmi (Grupi A), me perjashtim te te dhenave kundershuese ne fleten e regjistrimit qe perjashtojne evolucione te mundshme te caktuara te vetures.
- Vetura prodhimi ne seri (Grupi N).

B) MBLEDHJE OSE ORGANIZIM TURISTIK

Keto jane aktivitete qe kane per qellim mbledhjen e pjesemarrsesve ne nje vend-ndodhje te caktuar, duke ndjekur nje rruge me distance zakonisht te vogel qe nuk i nenshtrohet kontrolleve kohore apo detyrimeve te shpejtesise mesatare. Mbledhjet nuk kane detyrimin e regjistrimit ne Kalendarin sportiv, por nuk mund te organizohen pa aprovimin e FASA.

C) RALLYES TOUT TERRAIN DHE RALLYES TOUT TERRAIN BAJA

Ne garat e Rallyes Tout Terrain gjatesia e cdo sektori nuk duhet te tejkaloje 500 km dhe gjatesia totale e gares duhet te jete te pakten 800 km. Itinerari mund te pershkoje territorin e disa ASN, duke pasur nje marreveshje paraprake ndermjet ketyre ASN. Ne keto gara mund te marrin pjese vetem mjetet Tout Terrain (Grupi T), sic percaktohet ne rregulloret e FIA.

Nje Rallye Tout Terrain Baja eshte nje Rallye Tout terrain qe dhjet te zhvillohet ne nje dite (gjatesia maksimale 800 km), ose ne dy dite (gjatesia maksimale 1.200 km).

D) RALLYES TOUT TERRAIN MARATHON

Keto gara duhet te regjistrohen ne Kalendarin Sportiv Nderkombetar. Ne nje kontinent mund te organizohet vetem nje Rallye Tout Terrain Marathon, me perjashtim te rasteve qe kane leje speciale nga FIA.

Gjatesia totale e gares duhet te jete te pakten 10.000 km. Kohezgjatja maksimale nuk duhet te tejkaloje 31 dite, perfshire edhe verifikimet teknike.

Mund te marrin pjese ne keto gara vetem mjetet Tout Terrain, sic percaktohet ne rregulloret e FIA.

Neni 22 – Gara, Parada, Shfaqje

A) GARA

Shih Nenin 16.

B) PARADA

Nje parade parashikon prezantimin e nje grup veturash me shpejtesi te reduktuar. Per organizimin e paradave duhet te permbushen keto kushte:

- nje veture e organizates hap paraden dhe nje tjeter e mbyll
- keto vetura duhet te drejtohen nga pilote eksperte
- parakalimet jane rreptesisht te ndaluara
- ndalohet kronometrimi
- veturat nuk duhet te kene numra gare, me perjashtim te rasteve kur ky numer lidhet me vete figuren historike te vetures. Organizatoret mund te perdorin mjete te tjera identifikuese (shkronja, etj.), por keto duhet te hiqen kur vetura largohet nga vendndodhja e parades
- ecuria e cdo parade duhet te percaktohet ne nje rregullore te vecante ku percaktohen edhe veturat qe mund te marrin pjese.

C) SHFAQJE

Nje shfaqje synon te tregojte aftesite e pilotit dhe performancat e nje veture. Per organizimin e nje shfaqje duhet te respektohen keto kushte:

- shfaqjet me me shume se pese vetura duhet te drejtohen nga nje makine sigurie e drejtuar nga nje pilot ekspert
- cdo pike kontrolli pergjate pistes duhet te drejtohet nga nje Komisar Piste
- veturat duhet te respektojne kushtet e sigurise
- pas verifikimeve teknike, duhet te publikohet nje liste e pjesemarresve
- nuk lejohen pasagjere
- pilotet duhet te veshin nje uniforme te posacme sigurie (keshillohen tutat dhe helmetat e aprovuara nga FIA). Organizatoret duhet te percaktojne kushtet e sigurise minimale
- ndalohen rreptesisht parakalimet, me perjashtim te rasteve kur kerkohen nga drejtuesit e gares duke shfaqur flamurin blu
- ndalohet kronometrimi
- cdo shfaqje duhet te pershkruhet ne nje rregullore te vecante qe duhet te percaktoje edhe veturat e lejuara
- veturat nuk duhet te kene numra gare, me perjashtim te rasteve kur ky numer lidhet me vete figuren historike te vetures. Organizatoret mund te perdorin mjete te tjera identifikuese (shkronja, etj.), por keto duhet te hiqen kur vetura largohet nga vendndodhja e shfaqjes

Paradat dhe Shfaqjet nuk mund te organizohen pa autorizimin e FASA.

Neni 23 – Testi / Kolaudimi

Behet fjale per nje prove te autorizuar ne te cilen cdo pjesemarrës mund te zgjedhe momentin per ta kryer, brenda limiteve te programit te specifikuar ne rregullore.

Neni 24 – Kampionate, Kupa, Trofe, Challenge dhe Seri

FASA percakton cdo vit Kampionatet dhe titujt e tjere kombetare dhe, duke marre parasysh kerkesat e Organizatoreve, percakton vlefshmerine e garave te rregjistruara ne Kalendarin Sportiv Kombetar. Nje Kampionat, nje Kupe, nje Trofe apo nje Challenge mund te perbehen nga nje seri garish, ose nga vetem nje e tille he mund te jene nderkombetare apo kombetare. Kampionatet, Kupat Trofete dhe aktivitetet Challenge nderkombetare jane kompetence e FIA, ato shqipetare jane kompetence e FASA. Vetem FIA mund te autorizojte aktivitetet nderkombetare dhe vetem FASA mund te autorizojte ato kombetare.

A) KAMPIONATE, KUPA, TROFE DHE CHALLENGE

Jashte terrotrit te Shqiperise mund te organizohet vetem nje gare Kampionati, Kupe, Trofeu apo Challenge kombetar, duke zbatuar kushtet e meposhtme:

- te zhvillohet ne nje vend qe ka nje kufi te perbashket me Shqiperine (ne rast se kufiri eshte detar, kerkohet aprovim paraprak nga FIA)
- qe rregullorja sportive dhe teknike e kampionatit kombetar te jene aprovuar nga FIA
- qe itinerari ne te cilin zhvillohet gara te jete aprovuar nga FIA dhe te gjithë rregullat e sigurise teknike dhe sanitare te jene respektuar.

B) SERI NDERKOMBETARE DHE KOMBETARE

Asnje Seri nderkombetare nuk mund te organizohet nese ASN qe ka propozuar zhvillimin e aktivitetit nuk ka marre me pare aprovimin e FIA.

b1) Seri nderkombetare

Nje seri aprovohet nese ploteson kushtet e meposhtme:

- FIA duhet te aprovoje rregulloren sportive dhe teknike te Serise, sidomos per sa i perket sigurise, si dhe kalendarin e garave qe perbejne Serine
- ASN-te qe organizojne nje apo me shume gara te Serise duhet te japin aprovimin e tyre
- Cirkuitet ku do te zhvillohen garat duhet te jene te pershtatshem per veturat pjesemarrese

b2) Seri kombetare

Serite kombetare zhvillohen brenda territorit te nje ASN. Kalendarin dhe rregulloret teknike e sportive duhet te aprovohen nga ASN perkatese.

Neni 25 – Komiteti Organizues

Entet dhe Shoqatat qe organizojne nje aktivitet sportiv duhet te ngrene nje Komitet Organizues me te pakten tre persona, te pelqyer nga FASA, te pergjegjshem teresisht per organizimin e materialit te aktivitetit si ne fazen pergatitore, ashtu edhe gjate zhvillimit.

Neni 26 – Leje Organizimi

Ky eshte nje dokument i leshuar nga FASA qe lejon organizimin e nje aktiviteti sportiv.

Neni 27 – Rregullore e vecante

Dokument zyrtar i detyrueshem i krijuar per te percaktuar menyren e zhvillimit te nje aktiviteti sportiv. Rregullorja e Vecante e Gares (RVG) duhet te ndertohet nga organizatori sipas normave te Ligjit Nderkombetar mbi Sportin dhe kesaj RKS, duke perdorur nese eshte e nevojshme edhe rregulloret tip te FIA dhe FASA. Per aktivitetet qe parashikojne shume gara RVG mund te jete unik per ceshtjet e perbashketa per gjithë garat, nderkohe qe duhet te ndertohet nje kapitull i vecante ku percaktohen gjithë ceshtjet specifike per cdo gare.

Neni 28 – Programi

Dokument zyrtar i detyrueshem, i ndertuar nga organizatori pas aprovimit te RVG nga FASA, qe informon publikun mbi zhvillimet e aktivitetit. Nese keto informacione perfshihen edhe ne RVG, kjo e fundit mund te zere vendin e progamit. Pese kopje te progamit duhet te dergohen ne FASA para fillimit te aktivitetit.

Neni 29 – Itinerari

Itinerari eshte rruga e detyrueshme qe duhet te pershkoje nje veture gjate gares, nga vija e nisjes deri ne vijen e finishit. Itinerari mund te jete i perhershem, i perkohshem ose gjysem i perhershem, ne varesi te mundesise se riperdorimit te tij ne aktivite.

Neni 30 – Pista

Itinerar i perdorur ne menyre te perhershme ose te perkohshme per gara ose percaktime rekordesh.

Neni31 – Autodromi

Quhen Autodrome gjithë cirkuitet e perhershem te pajisur me instalime te kompletuara dhe pista te ndertuara enkas per gara automobilistike me karakteristika specifike.

Neni 32 – Milje, Kilometer

Per gjithë kalimet nga njesi britanike ne njesi metrike dhe anasjelltas, milja do te konsiderohet 1.609,344 metra dhe kilometri 0,62137 milje.

Neni 33 – Rekord

Rezultati maksimal i arritur nga nje veture ne kushte te vecanta te parashikuara nga rregulloret.

Neni 34 – Rekord lokal

Nje rekord i arritur apo i tejkualuar ne nje piste te perhershme apo te perkohshme, te aprovuar nga ASN, cfaredo qofte kombesia e konkurentit.

Neni 35 – Rekord Kombetar

Nje rekord i arritur apo i tejkualuar sipas rregullave te percaktuara nga nje ASN ne territorin e saj, ose ne territorin e nje ASN tjeter e cila lejon paraprakisht aktivitetin. Nje rekord kombetar mund te jete i nje “Klase”, nese perfaqeson performancat me te mira te realizuara ne nje nga Klasat qe ndahen veturat qe pranohen ne kete aktivitet, ose mund te jete “Absolut” nese perfaqeson performancat me te mira pa marre parasysh Klasat.

Neni 36 – Rekord Nderkombetar

Nenkuptohet performanca me e mire e realizuar nga nje veture pa marre parasysh kategorine, klasen, grupin apo ndonje kriter tjeter diferencues.

Neni 37 – Rekord Boteror

Nje rekord i njohur nga FIA si erformanca me e mire e realizuar nga nje veture pa marre parasysh kategorine, klasen, grupin apo ndonje kriter tjeter diferencues.

Neni 38 – Mbajtes i Rekordit

Nese rekordi eshte arritur apo tejkualuar gjate nje tentative individuale, eshte mbajtes i tij konkurenti qe ka marre lejen dhe ka nenshkuar kerkesen e autorizimit. Nese rekordi eshte arritur apo tejkualuar gjate nje gare, eshte mbajtes konkurenti ne emer te te cilit eshte rregjistruar vetura me te cilen eshte realizuar performanca.

Neni 39 – Nisja

Nisja eshte momenti ne te cilin i jepet sinjali i nisjes nje konkurenti apo nje grupi konkurentesh qe nisen se bashku.

Neni 40 – Linja e kontrollit

Linja ne te cilen kontrollohet kalimi i nje mjeti, me ose pa kronometer.

Neni 41 – Vija e nisjes

Eshte vija e kontrollit fillestar, me ose pa kronometrim.

Neni 42 – Vija e mberritjes dhe parku i mbyllur

A) VIJA E MBERRITJES

Eshte vija e kontrollit final, me ose pa kronometrim.

B) PARK I MBYLLUR

Eshte vendi ku konkurenti eshte i detyruar te vendose veturen, sipas RVG. Ne brendesi te parkut te mbyllur lejohet hyrja vetem per stafin e gares dhe ndalohet cdo veprim perгатitor apo riparimi, me perjashtim te rasteve qe lejohet nga stafi i gares. Stafi i gares qe lejohet te hyje ne park percaktohet nga Organizatori; pjesetaret e stafit jane pergjegjes per mbarevajtjen e parkut te mbyllur. Parku i mbyllur eshte i detyrueshem per gjithë garat qe parashikojne verifikime teknike. RVG duhet te percaktoje vend-ndodhjen e parkut. Ky i fundit duhet te pozicionohet ne afersi te vijes se mberritjes.

Neni 43 – Handicap

Penalizim fillestar i parashikuar nga RVG per nje veture per te kompensuar sa me shume dizavantazhin e performancave me veturat e tjera.

Neni 44 – Konkurent

Konkurenti eshte nje person fizik ose juridik qe rregjistron ne nje gare nje autoveture dhe pilotin/tet. Konkurenti duhet te jete i pajisur me licence sportive per konkurente te leshuar nga FASA.

Neni 45 – Piloti

Piloti eshte kushdo qe drejton nje veture ne nje gare. Ai duhet te pajiset me licence sportive per pilote te leshuar nga FASA. Piloti mund te jete edhe konkurent, dhe ne kete rast duhet te pajiset me licence piloti dhe konkurenti, pervec rasteve te specifikuara ne rregulloret e posacme te FASA.

Neni 46 – Pasagjeri

Person i ndryshem nga piloti qe transportohet ne veture, qe ka peshe me te larte se 60 kg (perjashto garat e rregullise) duke perfshire edhe pajisjet personale.

Neni 46/2 – Perjashtime nga pjesemarrja ne gare

Stafi i gares nuk mund te marre pjese ne gare si konkurent dhe/apo pilot. Pjesetaret e Komitetit Organizues nuk mund te marrin pjese si konkurente dhe /apo pilote ne garat e organizuara prej tyre. Pilotet e klasifikuar nga FIA nuk mund te marrin pjese ne gara nderkombetare dhe as ne garat F.3 (edhe nese jane gara nderkombetare te lira) nese garat zhvillohen jashte Shtetit ku kane marre licencen.

Neni 47 – Liçenca

A) PERKUFIZIME

Licenca eshte nje certifikate regjistrimi qe i leshohet nje personi juridik apo fizik (pilot, konkurent, konstruktor, skuader, staf i gares, organizator, cirkuit, etj.) qe synon te marre pjese ne cfaredo lloj aktiviteti sportiv automobilistik qe parashikohet ne Ligjin Nderkombetar mbi Sportin dhe ne kete RKS. Mbajtesit e nje prej licencave te mesiperme duhet te njohin dhe respektojne dispozitat e Ligjit Nderkombetar mbi Sportin dhe kete RKS. Per te marre pjese ne nje gare apo per te percaktuar dhe vendosur nje rekord te ri, nevojitet licenca e leshuar nga FASA. Statusi i sportistit me licence, me perjashtim te rasteve kur licenca rinovohet ne fund te vitit, eshte i vlefshem deri ne castin kur perfundon afati i licences apo sportisti heq dore publikisht prej saj, si dhe ne rastet e skualifikimeve dhe perjashtimeve.

B) LICENCA NDERKOMBETARE

Te gjitha licencat nderkombetare te leshuara nga FASA jane te vlefshme per te marre pjese ne nje gare nderkombetare, ne baze te grades se licences dhe me kusht qe gara te jete rregjistruar ne Kalendarin Sportiv Nderkombetar. Keto licenca duhet te rinovohen cdo vit, duke filluar nga 1 Janari. Leshimi i licenses behet pas pageses se takses perkatese. FASA mund ti leshoje nje licence sportive nje shtetasi te huaj vendi I te cilit nuk ka ende perfaqesi ne FIA, me aprovim paraprak nga FIA. Lista me keto licenca ruhet ne sekretarine e FASA dhe cdo ASN e nje vendi qe ben pjese ne FIA eshte e detyruar te njohe keto licenca. Super Licenca Nderkombetare i leshohet nga FIA sipas kerkeses nje sportisti qe eshte mbajtes i nje licence kombetare sportive. Kjo licence eshte e detyrueshme per disa kampionate nderkombetare pasi kerkihet ne rregullore. Super Licenca eshte nje kompetence e FIA dhe si pasoje ajo ka te drejten te refuzoje nje kerkese per tu pajisur me Super Licence, duke motivuar refuzimin.

C) LICENCA KOMBETARE

Licencat Kombetare te leshuara nga FASA jane te vlefshme per te marre pjese ne gara qe zhvillohen ne territorin e Shqiperise, me perjashtim te rastit te pershkruar ne Nenin 18 dhe me kusht qe ne licence te vendoset logo e BE.

Neni 48 – Regjistri i licencave

Eshte lista e gjithe sportisteve te cileve i eshte leshuar nje licence sportive, e cila ruhet nga FASA.

Neni 49 – Numri i licences

Eshte numri qe i atribuohet cdo personi fizik apo juridik qe rezulton i regjistruar ne regjistrin e licencave.

Neni 50 – Perjashtimi

Perjashtimi mund ti referohet klasifikimit apo aktivitetit ose gares. Perjashtimi nga klasifikimi parashikon anulimin e rezultatit ne gare per personin qe i drejtohet. Perjashtimi nga aktiviteti ose nga gara parashikon mos-lejimin per te marre pjese ne ate apo me shume gara qe perbejne vete aktivitetin.

Neni 51 – Pezullimi i licences

Pezullimi i licences anulon perkohesisht te drejten per te marre pjese ne cfaredo lloj aktiviteti sportiv ne territorin e Shqiperise si dhe ne vendet qe i nenshtrohen ligjeve te FIA.

Neni 52 – Skualifikimi

Skualifikimi anulon perfundimisht te drejten per te marre pjese ne cfaredo lloj aktiviteti sportiv automobilistik.

Kapitulli 3

Gara – Kushte te pergjithshme

Neni 53 – Kushte te pergjithshme te aplikimit te RKS dhe Ligjit Nderkombetar mbi Sportin

Te gjithë garat dhe tentativat per te vendosur nje rekord kombëtar, nderkombetar apo botëror te organizuara ne nje Shtet qe perfaqesohet ne FIA, i nënshtrohen Ligjit Nderkombetar mbi Sportin dhe, per sa i perket Shqiperise i nënshtrohen edhe kësaj RKS.

Garat e llojit te mbyllur apo te rezervuar dhe tentativat per rekorde lokale i nënshtrohen vetem kësaj RKS.

Neni 54 – Gare e organizuar ne nje vend qe nuk perfaqesohet ne FIA

Nje gare nuk mund te organizohet ne nje vend qe nuk perfaqesohet ne FIA, me përjashtim te rasteve kur merret autorizim nga vete FIA.

Neni 55 – Organizimi i garave

Ne Shqiperi nje gare mund te organizohet:

- a) nga Automobile Club Albania
- b) nga nje Automobile Club rajonal qe eshte mbajtes i licences se organizatorit dhe qe ka marre leje te rregullt per te organizuar garen nga FASA
- c) nga Ente apo Shoqata mbajtëse te licences se organizatorit qe kane marre leje te rregullt per te regjistruar aktivitetin ne Kalendarin Sportiv Kombetar dhe leje per te organizuar garen nga FASA

FASA mund ti kerkoje organizatoreve derdhjen e nje fondi sigurie qe te mbuloje dhënien e cmimeve per garen.

Neni 56 – Dokumenta zyrtare

Per cdo gare duhet te ndertohet nje Regullore e Veçante e Gares (RVG, Neni 27) dhe nje program zyrtar (Neni 28). Cdo dispozite e perfshire ne RVG apo ne program qe bie ndesh me Nenet e Ligjit Nderkombetar mbi Sportin dhe Nenet e kësaj RKS konsiderohet automatikisht e pavlefshme.

Neni 57 – Citim i detyrueshem ne dokumentat e gares

Ne gjithë RVG, programet dhe formularet e regjistrimit duhet te citohet shprehimisht se “gara organizohet konform Ligjit Nderkombetar mbi Sportin dhe Rregullores Kombetare Sportive”.

Neni 58 – Njohja dhe respektimi i Rregullave

Kushdo merret me aktivitete sportive ne fushen e automobilizmit eshte i detyruar te njohe Ligjin Nderkombetar mbi Sportin dhe kete RKS, si dhe duhet te respektoje vendimet e Autoritetit Sportiv dhe te pranoje pasojat e veprimeve te tij (Neni 7/4). Mos respektimi i Ligjit Nderkombetar mbi Sportin dhe i kesaj RKS nga aktoret e perfshire ne kete sport parashikon aplikimin e disa sanksioneve te motivuara qe mund te cojne deri ne skualifikim nga aktivitetet kombetare dhe nderkombetare. Ky Nen aplikohet mbi cdo mbajtes licence, qofte ky pilot, konkurrent, konstruktor, komisar gare, etj.

Neni 59 – Gara te ndaluara

Cdo gare qe nuk organizohet konform dispozitave te Ligjit Nderkombetar mbi Sportin dhe kesaj RKS eshte e ndaluar nga FASA. Nese nje gare e palejuar zhvillohet gjate nje aktiviteti per te cilin eshte leshuar leje zyrtare, kjo e fundit konsiderohet automatikisht e pavlefshme.

Neni 60 – Gara te shtyra apo te anuluar

Nje aktivitet apo nje gare qe zhvillohet gjate nje aktiviteti, mund te shtyhet ose anulohet vetem per arsye te jashtezakonshme ose nese Komisaret Sportive e gjykojne te arsyeshme per arsye madhore apo sigurie. Ne rast se shtyrja tejkalon 24 oret, taksat e regjistrimit rimbursohen.

Kapitulli 4

Gara – Rregullore e Vecante e Gares

Zhvillimi - Regjistrimi

Neni 61- Kalendar Sportiv Kombetar

A) NORMA TE PERGJITHSHME

Kalendar Sportiv kombetar eshte kalendar i evenimenteve sportive te organizuara ne Shqiperi pergjate vitit. Per ç’do eveniment, Kalendar Sportiv tregon karakteristikat e zhvillimit (Neni 16 dhe vijues). Organizatoret qe duan te vendosin nje aktivitet sportiv ne Kalendar duhet te bejne nje kerkese prane FASA sipas procedurave te pershkruara ne rregulloret e posaçme te FASA. FASA miraton Kalendarin duke patur parasysh kerkesat e bera nga organizatoret dhe Kalendarin nderkombetar te FIA. Nuk mund te organizohen ne te njejten date evenimente sportive me te njejtat karakteristika, kur vendet e zhvillimit te tyre jane relativisht prane njeri-tjetrit. Ne rastet e kerkesave per evenimente te tilla FASA ka te drejte te vendose ne menyre perfundimtare dhe te pakthyeshme, duke i dhene perparesi ne renditje kur kushtet e tjera jane te njejta, evenimenteve nderkombetare (duke respektuar perparesine e vendosur nga FIA), evenimenteve te vlefshme per Kampionate, Kupa ose Trofe kombetar. Pasi eshte aprovuar Kalendar Kombetar, FASA, sipas gjykimit te saj, duke pare disponueshmerine e datave dhe ne respektim me procedurat, mund te pranoje rregjistrimin ne Kalendar te evenimenteve te tjera.

B) EMERTIMI I EVENIMENTEVE SPORTIVE

Emertimi i aktiviteteve sportive i nenshtrohet pelqimit te FASA. Asnje eveniment sportiv nuk mund te marre emertimin e nje evenimenti tjetër te organizuar ne te shkuaren ose te tille qe te krijoje keqkuptime me te, pa konsensusin e Organizatorit te saj. Ne raste mosmarreshjesh vendos ne menyre te pa diskutueshme dhe perfundimtare Presidenti i FASA. Emertimi “Çmimi i Madh” i jepet evenimenteve sportive te nje rendesie te veçante dhe sipas kritereve te vendosura nga FIA. Emertimi i ndjekur nga “i Automobile Club Albania” rezervohet ne menyre ekskluzive vetem per aktivitetet e Automobile Club Albania. Emertimi “Kampionati Shqiptar”, “Kampionati Kombetar”, “Trofeu Kombetar”, “Challenge Kombetar”, “Kupa Kombetare ose FASA” si dhe emertimet e ndjekura nga “Shqiperia”, “Albania” ose “Kombetar/e” jane te rezervuara per FASA.

C) RREGJISTRIMI NE KALENDAR I EVENIMENTEVE NDERKOMBETARE

Rregjistrimi ne Kalendarin Kombetar te evenimenteve nderkombetare te lira ose jo, ashtu si dhe percaktimi i tyre per Kampionate, Trofe, Kupa dhe gara Challenge te FIA, jane te percaktuara ne rregulloret e posaçme te FASA.

Neni 61/2 – Leje organizimi

Asnje aktivitet sportiv nuk mund te organizohet ne Shqiperi pa lejen e organizimit te leshuar nga FASA (neni 26).

Neni 62 – Kerkesa per leje organizimi

Leja e organizimit te nje aktiviteti sportiv duhet te kerkohet prane FASA ne afatin dhe menyren e vendosur ne rregulloren e posaçme. Kerkesa e lejes se organizimit duhet te jete e shoqeruar nga drafti i RVG dhe programit ne dy kopje (neni 65).

Neni 63 – Dhenia e lejes se organizimit

FASA, pasi te shqyrtoje rregjistrimin ne Kalendar dhe respektimin e normave ne lidhje me kerkesen e lejes se organizimit, i kthen derguesit nje kopje te draftit te Rregullores se Veçante te Gares se aprovuar, pasi ka verifikuar qe eshte konform normave te Ligjit Nderkombetar mbi Sportin dhe te kesaj RKS, si dhe ka bere ndryshimet e nevojshme ne nje periudhe kohore maksimale prej 15 ditesh nga dita kur ka marre ne dorezim kerkesen. Nënshkrimi dhe vula ne nje pjese te veçante te Rregullores se Gares ose nje leter e nënshkruar dhe e vulosur nga organet e FASA perbejne lejen e organizimit zyrtare te aktivitetit. Dhenia e lejes se organizimit nuk kerkon asnje takse shtese te bashkengjitur asaj te regjistrimit te aktivitetit ne Kalendar.

Neni 64 – Respektimi i normave dhe rregulloreve

Nje aktivitet mund te zhvillohet si ne rruge ashtu edhe ne piste ose ne te dyja njekohesisht.

Si parim i pergjithshem dhe i aplikueshem ne te gjitha aktivitetet, titullaret qe zoterojne nje licence si organizator dhe kerkojne te marrin leje organizimi mund ta marrin ate vetem nese respektojne dispozitat e Ligjit Nderkombetar mbi Sportin dhe te kesaj RKS. Organizatorët bashke me kerkesen per lejen e organizimit, marrin persiper te pajisen me autorizimet administrative, perfshire ato per miratimin e vendit se ku do te organizohet aktiviteti si dhe ti binden te gjitha rregullave te vendosura nga autoritetet shtetere shqiptare dhe ato te sigurise publike.

1. Aktivitetet e organizuara ne rruge qe perdoren per levizjen e automjeteve normale duhet te zhvillohen konform Kodit Rrugor. Shkeljet duhet te sanksionohen nga Komisarët Sportiv.
2. Aktivitetet e organizuara ne autodrom duhet te respektojne Ligjin Nderkombetar mbi Sportin dhe kete RKS, por mund te duhet te respektojne edhe dispozita te tjera te veçanta te vendosura qellimisht per te disiplinuar drejtimin e veturave te aktivitetit ne nje autodrom.
3. Rregulloret e veçanta te garave per Kampionatet e FIA duhet t'i dergohen Sekretarise se FIA te pakten nje muaj para dates se mbylles se rregjistrimeve, me perjashtim te garave Rrallyes ku afati kohor eshte dy muaj.

Neni 65 – Te dhena kryesore qe duhet te figurojne ne Rregulloren e Veçante te Gares

Rregullorja e Veçante e Gares (RVG), e firmosur nga juristi perfaqesues i Organizatorit, duhet te permbaje te dhenat kryesore ne vazhdim:

- a) Organizatori dhe Komiteti Organizator (selite e tyre).
- b) Klasifikimin dhe emertimin e aktivitetit dhe vlefshmerine e mundshme per Kampionate, Kupa, Trofe, etj. dhe informacionin e detajuar per ç'do gare qe perfshihet ne program.
- c) Deklarimin se aktiviteti eshte i organizuar konform Ligjit Nderkombetar mbi Sportin dhe te kesaj RKS.
- d) Daten dhe vendndodhjen e zhvillimit.
- e) Itinerarin (pershkrimin, gjatesine, sensin e drejtimit).
- f) Distancen ose periudhen kohore.
- g) Konkurentet dhe drejtuesit e pranuar si dhe licencat sportive qe kerkohen.
- h) Karakteristikat dhe klasifikimin e autoveturave qe do te marrin pjese.
- i) Taksat, periudha kohore dhe menyren e rregjistrimit.
- j) Adresen e Organit Drejtues te Gares dhe veçanerisht adresen se ku do te behet publikimi i komunikatave zyrtare me interes per konkurentet (lista e nisjes, klasifikime, masa disiplinore, etj.).
- k) Te dhena persa i perket:
 - kontrollit paraprak, verifikimit dhe procedurat e gares;
 - provave zyrtare, provave te lira te mundshme;
 - nisjes dhe numrit maksimal te mundshem te konkurrenteve;
 - zhvillimit te garave individuale;

- box-eve te pistes, riparimeve, furnizimit me karburant;
 - finishit;
 - parkut te mbyllur dhe procedurat e verifikimit pas gares;
 - klasifikimit: kriteret e percaktimit, ora dhe vendi i publikimit;
 - reklamimit dhe apelimit;
 - çmimeve: lloji, sasia, ndarja dhe shperndarja;
- l) Menyren e procedimit me:
- sigurimet e Komitetit Organizues dhe te Piloteve;
 - karburantin;
 - mbikqyrjen e itinerarit dhe sinjalistikes;
 - masat e sigurise, kokoret (kaska), veshjet dhe rripat e sigurimit;
 - reklamat ne vetura;
 - numrat e gares, targat, shenjat e tjera dalluese;
- m) Deklarimi se aktiviteti mund te shtyhet ose anulohet vetem ne rastet per shkaqe te jashtëzakonshme per te cilat duhet te infomohet FASA ose ne baze te nje vendimi nga Komisaret Sportive per arsye madhore apo sigurie.
- n) Lista e emrave te stafit te gares (Komisare Sportive, Komisare Teknike, Drejtues te Gares, etj.), Inspektorit per Sigurine, mjekut pergjegjes, etj.

Neni 66 – Ndryshimi i Rregulloreve te Vecanta te Gares

Ndryshimet e bera ne RVG para hapjes se regjistrimeve duhet te jene aprovuar nga FASA (ose nga FIA ne rast te garave te vlefshme ose kandidate per nje titull FIA) dhe te shfaqen ne nje qarkore te posaçme. Pas hapjes se regjistrimeve e deri ne fillim te verifikimit para gares, ndryshimet duhen bere nga Organizatoret dhe duhet te marrin aprovimin e Komisareve Sportive, pervec rasteve te ndryshimeve ne afatet kohore te caktuara me pare dhe te itinerarit qe duhet te marrin aprovimin e FASA (ose te FIA ne rast te garave te vlefshme ose kandidate per nje titull FIA). Gjate zhvillimit te aktivitetit, ç’do ndryshim duhet te jete i motivuar nga shkaqe madhore ose sigurie dhe nga arsye te dokumentuara, si dhe duhet ti nenshtrohet aprovimit te Kolegjit te Komisareve Sportive dhe tu behet e ditur konkurenteve.

Rregulloret e Vecanta te Gares jane pjese perberese e kësaj RKS dhe perfshijne disa ceshtje specifike (si p.sh. taksat e gares, rregullore teknike, kushtet e sigurise dhe cdo ceshtje tjeter qe nuk eshte specifikuar ne kete RKS), ndaj per organizimin e cdo aktiviteti sportiv te miratuar nga FASA duhen ndjekur dispozitat e përcaktuara ne RVG. FASA ne ç’do rast ruan te drejten te ndryshoje RVG e aprovuara.